



Datë: 20.04.2026

A.nr.310/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.310/2026, të datës 18.03.2026, të parashtruar nga ankuesi F.A, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokateve “Klinika & Associates L.L.C” kundër organit të punësimit: Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 20.04.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.310/2026, të datës 18.03.2026, parashtruar nga ankuesi F.A.

II. Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të kontestit juridik-civil pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesi F.A (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 18.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin mbi të drejtën e kompensimit të përvojës së punës prej 0.25% nga koha kur ha hy në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publik dhe tani e tutje nga 0.5%.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.03.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, ndërsa, kjo e fundit më datë 03.04.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1392/2026 të datës 18.03.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.03.2026; Formularin e regjistrimit të ankesës të datës 18.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës

03.04.2026, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Akt emërimi i F.A, i datës 02.08.2018; Formulari i përshkrimit të punës; Vërtetim i marrëdhënies së punës me numër Ref:4/4-30, i datës 31.03.2026; Kërkesë me numër protokoll Nr.8-749, e datës 20.02.2026; Autorizim; E-mail i datës 31.03.2026; Vendim për pensionim me numër Ref:2/069, i datës 17.01.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi, **sepse**:

I. Gjendja e çështjes

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 02.08.2018, është i punësuar në pozitën *Zyrtar për transport-4* në Zyrën e Sekretarit, në kuadër të Ministrisë e Arsimit dhe Shkencës, ndërsa, më Vendimin nr.prot: 2/069, të datës 17.01.2023, të Sekretares së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (atehërë MSHTI) i ka përfunduar marrëdhënia së punës së ankuesit për arsye të arritjes së moshës së pensionimit, me efekt nga data 03.05.2023.

Tutje sipas shkresave të lëndës del se ankuesi përmes përfaqësuesit më autorizim, më datë 20.02.2026 i është drejtuar Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për kompensimin e diferencës së vlerës sipas përvojës së punës prej 0.25% në 0.5% nga koha kur ka hyrë në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publikë dhe në vazhdimësi. Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, më datë 31.03.2026 përmes përgjigjes në kërkesë ka njoftuar palën ankuese se Gjykata Kushtetuese ka obliguar që fillimisht (brenda 6 muajsh) të ndryshohet ligji i pagave dhe e më pas nga shkurti 2024 kjo të llogaritet në mënyrë retroaktive. Mirëpo, meqenëse ende nuk është ndryshuar ligji për pagat në Sektorin Publik duhet të zbatohet ligji në fuqi ashtu që kërkesa refuzohet.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i mohohet e drejta për kompensimin e vlerës së përvojës nga 0.25% në 0.5% nga koha kur ka hyrë në fuqi ligji i pagave në sektorin publikë dhe se kjo e drejtë i është njohur me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kërkon që ankesa të aprovet dhe të kompensohet diferenca e përvojës së punës në pagë prej 0.5% nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Rrjedhimisht, në kuptim të kompetencës materiale të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji fillimisht thekson faktin se ankuesi deri me datë 03.04.2023, kishte statusin e nëpunësit civil, gjegjësisht, nga data 04.04.2023, ankuesi ka humbur statusin e nëpunësit civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Andaj, duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më të cilin përcaktohet së Këshilli ka juridiksion që të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe

kandidatëve për pranim në shërbimin civil, atëherë, duke qenë së ankuesi më rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill nuk ka statusin e nëpunësit aktiv civil, Kolegji konstaton se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuses A.nr.310/2026.

Si rrjedhojë, referuar pretendimeve ankimore të parashtruara si në ankesë, rezulton se në rastin konkret kemi të bëjmë më raport juridiko-civil, kështu që, Kolegji lidhur më të drejtën e ankuesit në mjete juridike si e drejtë kushtetuese garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), udhëzon palën ankuese që të drejtën e tij materiale të pretenduar si në ankesë ta realizoj në kontest civil në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Procedurën Kontestimore.

Thënë si me sipër e në mbështetje të nenit 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.310/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit/ Shoqërisë së avokatëve Klinaku&Associates L.L.C;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.